

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“IGR CONS “ sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 24/02/2021 une,

GERALD RADOMI, lindur me 04/07/1987, ne Ersekë , nënshtetas Shqiptar, madhor e me zotesi të plotë për të vepruar, zotëruar i dokumentit te identifikimit nr personal I70704031Q dhe banues në Tirane, Shqiperi.

Në cilësinë e “ortakut themelues“ kam rënë dakort për hartimin e këtij akt themelimi të mëposhtëm, të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar( më poshtë shoqëria) aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, të cilit i bashkëngjitet ( më poshtë shtojca 1).

**Neni 1**  
**Emertimi**

Emërtimi i Shoqerisë është **“IGR CONS “ sh.p.k.**

**Neni 2**  
**Selia**

Shoqëria e ka selinë në Rruga Ali Visha, Pall Genner 2, kati 1, Tirane , Shqipëri. Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, si edhe të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

**Neni 3**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore të pakufizuar.

**Neni 4**  
**Objekti i veprimtarisë**

Shoqeria **“IGR CONS ” shpk** do te ketë si objekt kryesor të veprimtarise së saj:

- ✓ Ndërtim objektesh të përmasave të ndryshme, shtëpi, vila, ndërtesa shumëkatëshe ose komplekse pallatesh, punime mirembajtje, shërbime fasadash. Ndërtim rrugësh dhe urash si dhe ndërtime portuale dhe rikonstrukcionin e tyre, asfaltim dhe veshje asfaltimi.
- ✓ Ndërtim veprash industriale civile e ushtarake, ndërtesa banimi, rruge, riparim asfalti, punime gërmimi ,etj në fushën e ndërtimit.
- ✓ Ndërtim Autostrada, Superstrada, Rrugë urbane dhe interurbane, ura , kalime dhe mbikalime,etj të kesaj natyre.
- ✓ Ndërtim digash, galeri, tuneli, ndërtim vepra kullimi, ujitje,impiante vaditese, punime mbrojtuese dhe sisteme hidraulike.
- ✓ Zbatim, projektim te ndërtimeve civile, ekonomike, punime dheu, sistemim taracime, prodhime elementesh te parafabrikuara, betoni e beton arme, ndertime civile e turistike

- ,rrugësh, vepra arti, hekurudha e kanalizime, punime karterie, investime në sektorin e energjetikës .
- ✓ Në fushën e ndërtimeve dhe montimeve elektrike si dhe veprimtari tregimi të materialeve elektrike me pakice e shumice import-eksport.
- ✓ Prodhimin e materialeve të ndertimit, materialeve elektrike, produkteve ushqimore, prodhimin e energjise elektrike .
- ✓ Projektim në fushën e ndërtimeve.
- ✓ Import – eksport, tregti me shumice dhe pakice te mjeteve te transportit dhe makinerive te ndryshme.
- ✓ Transport mallrash e pasagjeresh.
- ✓ Gjüeti sportive.
- ✓ Aktivitet minerar dhe pune me lende plasese.
- ✓ Import eksport mineralesh,gure derokativ, tregtimin me shumice e pakice e tyre.
- ✓ Furnizimin Publik me Pakice te energjise elektrike dhe tregtimin e energjise elektrike.
- ✓ Tregtim Materiale Hidraulike.
- ✓ Sherbime Portuale.

Veç sa më sipër shoqëria mund të kryeje çdo lloj aktiviteti tregtar dhe industrial, në përputhje me dispozitat ligjore të legjislacionit shqiptar dhe të huaj.

#### Neni 5

#### Kapitali themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100,000 ( njeqind mijë) Lekë.

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100,000( Njeqind mijë) lekë:

Kjo kuotë kapitali është e shlyer tërësisht dhe mbajtës/ pronar i kësaj kuote është z. GERALD RADOMI

#### Neni 6

#### Transfërimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të statutit.

#### Neni 7.

#### Administrimi

Administrator i shoqerisë do të jetë Z. Laert Petritaj, nënshtetas Shqiptar, madhor e me zotesi të plete per te vepruar, zoterues i dokumentit te identifikimit me nr personal J31012019P, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjecar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 8  
Kompetencat

*Administratori ka te drejtë e detyrohet të:*

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.
- f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;
- g) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 9  
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera të njëjtë juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare “**IGR CONS**” shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orginale.

**ORTAK I VETEM I SHOQERISE**

*Administratori  
Dacrit Petritof  
DPP*

Ing. GERALD RÄDOMI

